



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **ZYRA E PERSONELIT**

**Nr.13-111/01-5155/19**

**Podujevë,**

**Më:24.01.2019**

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komuna e Podujevës, shpall:

## **K O N K U R S**

**Për plotësimin e vendit të lirë të punës:**

**I.Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

**Pozita: Mjek i Përgjithshëm i QKMF- së në Podujevë (1 pozitë)**

**Koeficienti : H - 565/1**

**Lloji i vendit të punës: me afat të pacaktuar, me orar të plotë (periudha provuese 6 muaj)**

### **Përshkrimi i detyrave të punës :**

- Ofron mbrojtjen primare shëndetsore për pacientin dhe familjen.
- Pranon pacientin nga Infermierja, shenon të dhënat në kartelë shëndetsore, merr anamnezen, bënë inspektimin, auskultimin dhe palpacionin, reanimimin, kardio pulmonar, bënë ekzaminimin e shpinës dhe referon pacientin për hulumtime të duhura,
- Bënë ekzaminimin e shpinës dhe ekstremiteteve ,bënë ekzaminimin rectal,referon pacientin për hulumtime të duhura
- Bënë diagnozen initiale dhe trajtimin me terapi adekuate,
- Udhëzon tek specialisti nëse është e domosdoshme,
- Kryen shërbime të shëndetit riprodiktiv,kujdesit antenatal dhe postnatal
- Bënë imunizimin (vaksinimin),
- Promovon edukimin shëndetsor,
- Trajton lëndime të vogla,
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme
- Bënë identifikimin e grupeve vulnerabile dhe të rrezikuara
- Bënë dhënjën e barërave dhe medikamenteve esenciale
- Gjatë punës së tij asistojnë infermieret
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit t DMF dhe Drejtorit

### Kualifikimet e kërkuara

- Diploma e Fakultetit për Mjekësi - Drejtimi i Përgjithshëm
- E domosdoshme Licenca e Punës

### Përvoja

- Të ketë 1(një) vit përvojë pune

### Dokumentet e kërkuara:

- Kopjen e diplomës së Fakultetit të Mjekësisë,
- Kopjen e licencës së punës
- Kopjen e letërnjoftimit apo të pasaportës
- Cdo dokument tjetër apo certifikatë trajnimi , që kandidati-ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.
- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter; - e dëshirueshme.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati e sjell pasi të pranohet në mardhënie pune).
- .Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime;

## **INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT**

Administrata e Kuvendit të Komunës ofron mundësi të barabarta punësimi dhe i mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistimit . Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** duke filluar nga data e publikimit më **24.01.2019** deri më datën **07.02.2019** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit. Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës. Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë . Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e personelit, në këtë numër të telefonit 038/ 570 – 732 / lok .126.

